



DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVA CUSTOMS

30.07.2021

DALJE - IZLAZ - PASSING

No/Br.Nr.

01/1338/2021

Drejtoria Qendrore - Opšta Uprava - Central Administration

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera*  
*- Ministry of Finance, Labour and Transfers*



*Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs*  
*Zyra e drejtorit të përgjithshëm*

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

REFERENCË:	05/47 Nr. prot.1049 2				
PËR/ZA/TO:	Besnik Osmani- Auditor i Përgjithshëm ,Republika e Kosovës.				
CC:	Naser Arllati -Ndihmës Auditor i Përgjithshëm; Fatlinda Ramosaj -Udhëheqëse e Auditimit; Blerina Krasniqi-Udhëheqëse ekipi				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Agron Llugaliu -Drejtor I Përgjithshëm i Doganës së Kosovës.				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani I Veprimit-Raporti Final i Doganës së Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 Dhjetor 2020				
Nr. i zyrës:	Tel & Fax (++	Lokacioni:	Drejtoria e Doganës, Lagjja	Data:	29.07/2021
Br. kancelarije:	381 38) 540	Kucni:	Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi	Datum:	
Room No.:	350 /540 836	Extension:	Prishtinë	Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/for action					
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					X

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax (++ 381 38) 540 350 /540 836

www.dogana-ks.org

I nderuar zt. Osmani,

Shpresoj se jeni mirë me shëndet dhe punët po ju shkojnë mbarë!

Ne kemi shqyrtuar dhe analizuar Raportin Final të prezantuar nga ekipi i auditimit të ZKA dhe kemi vlerësuar gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport.

Dëshiroj po ashtu të ju falënderojmë për punën profesionale që ekipi juaj ka bërë gjatë auditimit të “Doganës së Kosovës për vitin financiar të përfunduar më 31 Dhjetor 2020” si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm që kanë pasur me zyrtarët doganor, për gjatë tërë kohës.


Duke e ditur peshën që ka raporti i auditimit për Institucionin e Doganës si dhe peshën që ky Institucion ka në shoqëri dhe për Buxhetiñ e Kosovës, ne si një Organizatë Buxhetore besojmë që konkluzionet dhe rekomandimet tuaja do të na ndihmojnë në arritjen e objektivave të parapara.

Ne kemi përgatitur Planin e Veprimit lidhu me adresimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport, si dhe masat që ne kemi ndërmarrë në lidhje me të gjeturat në Raportin Final.

Komentet tona dhe përkushtimi për Implementimin e Rekomandimeve (konkretisht përmirësimin eventual) janë domethënës dhe na ndihmojnë për përmirësimin e performancës së institucionit tonë në vazhdimësi.

Jeni të mirëseardhur në auditimet e radhës!

Me respekt,  
Agron Llugaliu  
Drejtor i Përgjithshëm  
Dogana e Kosovës



29 Korrik 2021

Prishtinë

Nr	Komponenta e Auditimit(ka pitulli)	Të gjeturat /Çështjet	Rekomandimi	Veprimet e Ndërmarra	Person at Përgjegjës	Afati i përfundimit
1.	Pasqyrat Vjetore Financiare	<p>Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 13, pika 3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me UA për planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.</p> <p>Nga testimi i pagesave përmes vendimeve gjyqësore kemi vërejtur se në tri mostra në vlerë 85,715€, nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin bërë pagesa për kompensim të pagave dhe përfitimeve tjera për punonjësit e suspenduar. Këto pagesa ishin ekzekutuar nga kodi 14410 (shpenzime nga vendimet e gjykatave) i mallrave dhe shërbimeve, ndërsa për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së pagave dhe mëditjeve, kodi 11900 (pagesa për vendime gjyqësore). Thesari kishte ndjekur procedurat që kërkohen për këto lloj pagesa, duke pyetur Doganën se nga cila kategori të bënte ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore dhe përgjigja ishte që mjetet të merren në kodin në të cilin ishin ekzekutuar këto pagesa.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se DK nuk kishte planifikuar mjete në kodin e pagesave për vendime gjyqësore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Sipas DK, deri më tani të gjitha pagesat për vendime gjyqësore janë planifikuar</p>	<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që planifikimi dhe realizimi i pagesave të bëhet në kategoritë ekonomike të duhura, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.</p>	<p>Vendimet gjyqësore deri me tani janë planifikuar dhe ekzekutuar nga kategoria mallra dhe shërbime ne kodin 14410, duke i përfshirë dhe vendimet për kompensim te pagave dhe përfitimeve tjera për punonjësit e suspenduar , arsyeya pse janë shpenzuar në këtë kod ekonomik ka qenë sepse nuk kemi pas planifikim në Kategorinë e Pagave respektivisht në kodin 11900 për këtë lloj shpenzimi.</p> <p>Pas rekomandimeve të marra duhet të bëhet planifikimi për këtë kod 11900 dhe te gjitha shpenzimet e vendimeve të gjykatave do të kategorizohen sipas rekomandimeve.</p>	ZKA ZKF	Shtator 2021

		dhe ekzekutuar nga kodi buxhetor 14410 i mallrave dhe shërbimeve.				
2.	<b>Investimet kapitale</b>	<p>Njoftimi për kontratë dhe dosja e tenderit për kontratën "Furnizimi me pajisje për caktimin e numrit oktanik dhe cetanik" përcaktonte shumën e sigurisë së ekzekutimit prej 10 % të vlerës së kontratës, për një periudhë të vlefshmërisë prej 13 muajve.</p> <p>Nga testimi i procedurave të prokurimit, kemi vërejtur se në kontratën "Furnizimi me pajisje për caktimin e numrit oktanik dhe cetanik" në vlerë 299,956€, siguria e ekzekutimit nuk mbulonte afatin e përcaktuar në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Bazuar në datën e nënshkrimit të kontratës, siguria e ekzekutimit të kontratës mbetet valide vetëm 12 muaj e 12 ditë më pak nga atë që ishte kërkuar në njoftimin për kontratë. Kjo kishte ndodhur për shkak të vonësive në nënshkrimin e kontratës,</p>	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të vazhduar periudhën e vlefshmërisë së kontratës në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e saj sipas kushteve të parapara.	Kontrata për "Furnizimi me pajisje për caktimin e numrit cetanik", Pjesa 2 me numër identifikues: 20113300-19-5451-1-1-1 ka qenë e planifikuar të nënshkruhet me datën 22.06.2020 (shih njoftimi për dhënie të kontratës i bashkangjitur). Por pasi që kontrata ka qenë me vlerë të madhe dhe është dashur të nënshkruhet edhe nga Ministria e Financave janë vonuar procedurat	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit	Janë ndërmarrë veprimet (bashkëlidhur gjeni emailin).

		<p>ndërsa siguria e ekzekutimit ishte bërë bazuar në datën kur kontrata ishte parashikuar të nënshkruhej nga të gjitha palët. Pas sugjerimeve tona, DK kishte bërë kërkesë për vazhdimin e afatit, mirëpo OE nuk i përgjigjur në kërkesë me arsyetimin për problemet me pandeminë.</p>		<p>e nënshkrimit. Ne kishim dërguar dosjen në ministri për nënshkrim të kësaj kontrate me kohë, por nga ministria është shqyrtuar drafti dhe kishin kërkuar një plotësim (shih bashkangjitur emaili me komunikim me MF). Kështu që OE ka dorëzuar para nënshkrimit të kontratës sigurinë e ekzekutimit të lëshuar me datë 15.06.2020 me vlefshmëri deri me datën 26.07.2021, afat ky që mbulonte mjaftueshëm kushtin e tenderit. Gjithashtu ne për të plotësuar këtë kusht, kemi komunikuar pandërprerë me OE dhe OE ka zgjatur sigurinë e ekzekutimit me kushte të njëjta deri me datën 16 Gusht 2021. Shih forma e bashkangjitur.</p>	
--	--	--	--	---	--

3.	Pasuritë	<p>Sipas nenit 6, pika 3 e Rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”. Më tutje, sipas nenit 19, paragrafit 4.7 të të njëjtës rregullore, duhet të bëhet hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore. Po ashtu, neni 20, përcakton se OB duhet të bëjë vlerësimin e pasurisë jo financiare për të vërtetuar nevojshmërinë e pasurisë jo financiare për organizatën, gjendjen fizike dhe mundësinë për ta përdorur në njësitë tjera të organizatës. Gjatë auditimit të menaxhimit të pasurive, ne kemi vërejtur si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• DK nuk ka një regjistër të plotë të pasurisë nën 1000€ në sistemin “e-pasuria”.</li> </ul> <p>Evidencat për pasuritë jo kapitale nën 1000€ mbahen në dy regjistra të ndara. Pasuritë jo kapitale të blera nga viti 2018 e tutje janë të regjistruara në sistemin “e-pasuria” (vlera 165,734€), ndërsa pasuritë tjera (vlera 199.265€) që i përkasin viteve të më hershme (para vitit 2018) janë të evidentuara në një sistem të brendshëm “Inventory”;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Komisioni i inventarizimit kishte përfunduar raportin e inventarizimit, mirëpo nuk e kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, siç kërkohet para përgatitjes së PFV-ve. Po ashtu, nuk ishte bërë vlerësimi i pasurive jo financiare përkundër nevojës për vlerësim, bazuar në gjendjen dhe rezultatet sipas raportit</li> </ul>	<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë jo financiare nën 1,000€ janë të regjistruara në sistemin “e-pasuria”, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i plotë dhe i saktë. Po ashtu, duhet të sigurojë që komisioni pas përfundimit të raportit të inventarizimit të bëjë harmonizimin e tij me regjistrat e pasurisë, para përgatitjes së PFV-ve, me qëllimin që të dhënat në PFV të prezantojnë gjendjen reale të pasurive me të cilat disponon organizata. Në rastet kur është e nevojshme, duhet të bëhet edhe vlerësimi i pasurisë bazuar në raportin e inventarizimit.</p>	<p>DK në bashkëpunim me MAP, IT, dhe njësi e pasurisë do të marr veprime për gjetjen e një zgjidhje ku do të mundësohet bartja e të dhënave nga Inventory në e-pasuria (migrimin e të dhënave).</p> <p>Për shkak pandemisë nuk është arrite me kohe të bëhet krahasimi dhe vlerësimi i pasurisë para përgatitjes së PVF. DK do ti kushtojë rëndësi që këtë vit të përfundojnë të gjitha këto procedura para përgatitjes së PVF.</p>	DK MAP	Fillimi Shtator-Dhjetor 2021.
----	----------	---	--	---	-----------	-------------------------------

		<p>të inventarizimit. Sipas DK, arsyeja e regjistrimit jo të plotë të pasurisë nën 1000€ në sistemin "e-pasuria" është për shkak të vonësive në bartjen e të gjitha të dhënave nga ana e MAP, e cila menaxhon me këtë softuer. Ndërsa arsyeja mosharmonizimit të regjistrave të pasurisë dhe mos vlerësimit të pasurive ishte për shkak të rrethanave pandemike dhe punës me staf të reduktuar.</p>				
--	--	---	--	--	--	--

Drejtoria e Doganës, Lagjja Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi 10.000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel & Fax (++ 381 38) 540 350 /540 836

[www.dogana-ke.org](http://www.dogana-ke.org)

